

**VENDIM**

**Nr.1065, datë 29.12.2010**

**PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E KRYERJES SË RIMBURSIMIT NGA TAKSA E  
BIZNESIT TË VOGËL TË PAGESËS PËR PAJISJET FISKALE DHE TAKSIMETRAT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Bizneseve, objekt i ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, që kanë bërë pagesën e blerjes së pajisjes së parë fiskale deri në datën 28.2.2011, nga “Shoqëritë e autorizuara”, sipas kontratës përkatëse, u rimburohet kjo pagesë deri në shumën 44 000 (dyzet e katër mijë) lekë, pa TVSH.

2. Tatimpaguesi duhet të dorëzojë pranë zyrës së taksave të bashkisë apo të komunës, ku është i regjistruar, brenda datës 31 mars 2011, formularin e rimbursimit të pagesës për pajisjen fiskale sipas formatit bashkëlidhur këtij vendimi, së bashku me dokumentacionin, si më poshtë vijon:

a) Kopjen e mandatpagesës së bërë për blerjen e pajisjes së parë fiskale ose kuponin tatimor, të shoqëruara me kopjen e faturës së blerjes;

b) Kopjen e kontratës me një nga “Shoqëritë e autorizuara” nga Ministri i Financave për ofrimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve fiskale në rastin e pajisjeve fiskale, ose shoqërinë shitëse, në rastin e taksimetrave;

c) Kopjen e njoftim-vlerësimit tatimor për vitin ushtrimor 2010, të lëshuar nga zyra e taksave të bashkisë ose të komunës.

ç) Deklaratën e vendosjes në punë të pajisjes fiskale.

3. Zyrat e taksave të bashkive ose të komunës, ku është i regjistruar tatimpaguesi, bëjnë përlllogaritjen e detyrimit të kësteve të taksës së biznesit të vogël, sipas nenit 11 të ligjit nr.9632, date 30.10.2006. Në rast se plotësohen kushtet e përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, rimbursimi fillon me këstin e tremujorit të katërt të vitit 2010, i cili paguhet deri në datën 20 janar 2011, dhe në rast se:

a) diferenca ndërmjet këstit për t’u paguar dhe shumës së rimbursueshme është pozitive, tatimpaguesi paguan këtë diferencë;

b) diferenca ndërmjet këstit për t’u paguar dhe shumës së rimbursueshme është negative, mbartet për t’u rimbursuar nga këstet pasardhëse.

4. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga afati i pagesës së këstit pasardhës të taksës së biznesit të vogël, drejtoritë rajonale të taksave, në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, rakordojnë me zyrat e taksave të bashkive dhe të komunave për shumat e pagesave të pajisjeve fiskale të biznesit të vogël për t’u rimbursuar nëpërmjet taksës së biznesit të vogël.

5. Bizneseve, subjekt i biznesit të vogël, që janë të përfshira në skemën e TVSH-së apo që do të përfshihen në skemën e TVSH-së brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e ligjit nr.10 354, date 18.11.2010 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për

sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, TVSH-ja e paguar për blerjen e pajisjes fiskale u kreditohet sipas procedurave të përcaktuara në ligjin për TVSH-në.

Bizneseve të tjera, që nuk janë të përfshira në skemën e TVSH-së dhe që nuk regjistrohen në skemën e TVSH-së brenda 6 (gjashtë) muajve, TVSH-ja e paguar për blerjen e pajisjes fiskale do t’u rimburohet nëpërmjet reduktimit të kësteve të taksës së biznesit të vogël.

6. Bizneseve, subjekt i biznesit të vogël, që operojnë në fushën e transportit sipas përcaktimeve të bëra në aneksin 5 të ligjit për taksat vendore dhe që kanë detyrimin për t’u pajisur me taksimetër, u rimburohet pagesa e bërë për blerjen e taksimetrit, sipas faturës përkatëse, deri në shumën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë, pa TVSH.

Dokumentacioni dhe procedura e këtij rimbursimi është e njëjtë si në rastin e rimbursimit për pajisjet fiskale, të përcaktuar në këtë vendim.

7. Ngarkohen Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Ministria e Brendshme dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Sali Berisha**

**Botuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 185, dhjetor 2010.**